# DËSHMI ARKIVI

**A-442282**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ishte me leje, Alket Rizai nuk u kthye në burg pas sherrit për muzikën në lokalin e plazhit |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/ishte-me-leje-alket-rizai-nuk-u-kthye-ne-burg-pas-sherrit-per-muziken-ne-lokalin-e-plazhit/1010447/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 08:00:32 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 07:57:43 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `43fedb8f5b7b231ff79c0b469cfa2cb2d04e90148f9f1c6aaead610abfaa0222` |
| TEKSTI | `520bd36a08282c673aa615d533d0c79a8d4e26ae38b63ba25fabb9b37bc04ba7` |
| PAMJA | `b506395cfca9cff4703e732ec577f04fc4cf515c1cbbe4785d10d1f5a091fbbc` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e157eebedd409116b1147438db1e91a2921cf9077af1c2759e5eccb9f5c9e875` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `ac1c8d986ca8a5982bff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e157eebedd409116b1147438db1e91a2921cf9077af1c2759e5eccb9f5c9e875`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ishte me leje, Alket Rizai nuk u kthye në burg pas sherrit për muzikën në lokalin e plazhit



Alket Rizai nuk është kthyer në burgun e Domokos, në Greqi, pas përfundimit të lejes së tij, duke u shpallur në kërkim nga autoritetet greke. Rizai dyshohet se është përfshirë në një incident të përgjakshëm në një bar plazhi në Anavyssos, në orët e para të së dielës, ku pati të shtëna me armë dhe dy persona mbetën të plagosur.

Rizai duhej të paraqitej në burg në orën 08:00, por nuk u kthye, duke aktivizuar procedurat për arrestimin e tij. Ajo që ka tërhequr vëmendjen e autoriteteve është fakti se shqiptari kishte përfituar 16 leje nga viti 2021 dhe ishte rikthyer në burg pas secilës prej tyre.

Sipas informacioneve paraprake, konflikti në lokalin e plazhit nisi pasi muzika u ndërpre për shkak të orarit të vonë. Grupi ku ndodhej Rizai ishte fillimisht brenda lokalit, por më pas doli jashtë.

Rizai dyshohet se shkoi drejt automjetit të tij së bashku me personat e tjerë dhe ndezi muzikën me volum të lartë. Pronari i lokalit doli për t'i tërhequr vëmendjen, çka solli një debat të ashpër. Situata u përshkallëzua brenda pak çastesh, ndërsa në vendngjarje ndodheshin edhe kalimtarë dhe punonjës të lokalit.

Sipas burimeve të cituara nga mediat greke, Rizai dyshohet se nxori një armë dhe mund të ketë qëlluar, ndoshta në ajër. Më pas, një shtetas afgan, i cili dyshohet se ishte i lidhur me sigurinë e lokalit, u përfshi në konflikt dhe thuhet se qëlloi në drejtim të Rizait.

Policia po përpiqet të përcaktojë se kush ka përdorur armën, sa të shtëna janë kryer dhe në çfarë drejtimi janë qëlluar. Në vendngjarje janë gjetur gëzhoja dhe gjurmë gjaku, të cilat po analizohen nga laboratorët mjeko-ligjorë.

Nga incidenti mbetën të plagosur një 20-vjeçar grek dhe një 41-vjeçar pakistanez. Gjendja e tyre shëndetësore pritet të jetë një nga elementet që do të ndihmojë hetuesit në zbardhjen e plotë të ngjarjes. Në lidhje me incidentin janë arrestuar pronari 41-vjeçar i barit të plazhit dhe bashkëshortja e tij 39-vjeçare.

Pronari akuzohet, ndër të tjera, për dëshmi të rreme, strehim të një personi që ka kryer vepër penale, pengim të

të fundit/


Berisha për nisjen e vitit shkollor: Shqipëria humbi rreth 5,900…


Nisja e vitit të ri shkollor shkakton kaos në qarkullin rrugor, rradh…


11 zjarre të regjistruara në Maqedoni gjatë 24 orëve, një prej tyre…


Dy gola me Juventusin, por Edon Zhegrova mbetet jashtë Kosovë…


Fabrizio Romano tregon prapaskenat: Spalletti shqyrtoi…


Kabineti i ri qeveritar Kurti 4 zhvillon sot takimin inaugurues


Barcelona gati të sakrifikojë fituesin e Kupës së Botës për t…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

drejtësisë dhe nxitje për posedim e përdorim të paligjshëm të armës. Bashkëshortja e tij akuzohet për dëshmi të rreme dhe nxitje për posedim e përdorim të paligjshëm të armës.

Ndërkohë, autoritetet greke vijojnë kërkimet për gjetjen e Alket Rizait dhe po hetojnë me detaje sekuencën e ngjarjeve për të përcaktuar se kush e nisi përplasjen dhe nëse incidenti përfundoi në një shkëmbim zjarri.

Shtuar më 14.09.2026 09:57

Tags: alket rizai , arratisja



Alket Rizai përfshihet në përplasje me a*më në Greqi, policia vihet në…



Nis viti i ri shkollor/ Nxënësit rikthehen në bankat e shkollës, 25 mij…



Emigracioni/ BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët, në Gjerma…



Protesta hyn në ditën e 107-të, paralajmërohet mosbindje civile: Kërkohe…



Njihuni me parashikimin e motit 14 Shtator 2026, ja sa do të jenë temperaturat



Rama në Elbasan: Bashkitë që do të bashkohen do të funksionojnë si qytete,…



"Rama na preu në besë"/ Divjaka shënon ditën e 45-të të protestës: Nuk…



Shehaj për debatet mbi pagat e magjistratëve: Rama u tërhoq pasi men…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.